



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MUNDËSI BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E TOKIOS

Universiteti i Tokios ofron programe me mundësi shkëmbimesh dhe transferimesh për studentë ndërkombëtarë në shkencat natyrore, teknike etj, duke filluar nga niveli *bachelor* deri në kërkimin shkencor. Nëpërmjet një programi 6-javor për praktikën kërkimore (program veror) Universiteti i Tokios ofron gjithashtu mbështetje për studentët që dëshirojnë të përfitojnë eksperiencë kërkimore. Konkretisht:

Shkolla e Shkencës në Universitetin e Tokios, i cili trajton çështje të “Shkencës Globale” (The Global Science Course, GSC) bazohet në një program të ri universitar 2-vjeçar, i cili është projektuar për të nxitur diversitetin ndërkulturor mes të rinjve nga e gjithë bota për të mësuar së bashku shkencën. Kursi “Shkenca Globale” kryhet në gjuhën angleze nga profesorë të njohur botërorë, të cilët ndjekin kërkimet për çështje të mprehta në fushat më të avancuara, me fokus: nxitja e studentëve për pjesëmarrje në komunitetet shkencore. Bursa mujore mbulon tarifat e shkollimit dhe shpenzimet e jetesës. Për më shumë informacion referojuni faqes së internetit: <http://www.s.u-tokyo.ac.jp/GSC/>.

Universiteti i Tokios ofron, gjithashtu, Programin “*The University of Tokyo Research Internship Program (UTRIP)*”, i cili parashikon një stazh pune 6-javore kryesisht për studentët e shkencave natyrore dhe të fushave të tjera relevante. UTRIP u ofron studentëve mundësi për të fituar përvojën e jetës reale akademike dhe shkencore në universitetin e Tokio-s. UTRIP është një program intensiv në fushën e kërkimit dhe angazhon studentë të cilët kanë interes të ndjekin studimet në Masterin e Shkencave ose PhD. Pjesëmarrësve në programin UTRIP do u jepet mbështetje financiare për të mbuluar kostot e akomodimit dhe të jetesës. Për më shumë informacion referojuni faqes UTRIP në adresë: <http://dww.s.u-tokyo.ac.jp/en/utrip>;

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit referojuni, gjithashtu, adresave të faqes online të Universitetit të Tokios:

<http://www.s.u-tokyo.ac.jp/en/overview/>

<http://www.s.u-tokyo.ac.jp/en/utrip/financial-support/>

<http://www.s.u-tokyo.ac.jp/en/utrip/apply-now/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE